LIGJ
Nr. 7601, datë 9.9.1992

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7504, DATË 30.7.1991 "PËR POLICINË E RENDIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dipozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit" në nenin 38, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Oficerë të policisë së rendit titullohen gjithë personat që mbarojnë shkollën e lartë të profilit të policisë, ose persona të tjerë që kanë mbaruar arsimin e lartë në profil tjetër dhe që i nënshtrohen një kursi special kualifikimi":

Neni 2

Neni 39 shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.301, datë 21.9.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.